



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së shtatë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e mbajtur më
29.09.2015, e cila filloi në orën 10:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Sami Hamiti, shef i GP-së (LDK), Hazir Borovci (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Sokol Krasniqi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Bekim Gashi (LDK), Naime Osmani (LDK), Vjollca Dibra – Ibrahimimi (LDK), Besa Rafuna (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Merita Surkishi (LDK), Flamur Shala (LDK), Abit Kastrati (LDK), Shiqeri Spahiu (LDK), Sylejman Pireva (LVV), Genc Sherifi (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Bardha Dida – Rogova (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Hatixhe Latifi – Pupovci (LVV), Qëndron Kastrati, shef i GP-së (LVV), Ylli Hoxha (LVV), Kreshnik Ahmeti (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Lirijeta Rexhepi (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Blerand Stavileci (PDK), Laura Zherka (PDK), Shaip Shabani (PDK), Islam Pacolli, shef i GP-së (AKR), Remzi Pacolli (AKR), Mirlinda Sopi (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Imer Rusinovci, shef i GP-së (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Abetare Fazliu (LB), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Kimet Zeqa (PD), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF), Nenad Miladinoviç, përfaqësues i subjektit politik (GIS) dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik (KDTP).

Munguan: Mustafë Krasniqi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK) dhe Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (LB).

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues.
Ai e hapi diskutimin për rendin e ditës.

Lirak Çelaj, për pikat 4, 5 dhe 6 të rendit të ditës, kërkoi të dijë se cila drejtori e ka bërë hartimin e këtyre materialeve dhe cila do të merret në fakt me këto pika. Lidhur me këtë çështje, ai tha se qëndrimi ynë politik është që deri sa Liburn Aliu të jetë në atë drejtori, të udhëhiqet nga ai, vetëm po e rikonfirmoj, që çdo propozim që vjen nga kjo drejtori, ne nuk do ta votojmë, nuk do ta trajtojmë fare.

Ylli Hoxha kërkoi që në rend dite të jetë temë diskutimi edhe çështja e marrëveshjeve në Bruksel dhe implikimeve të tyre në Komunën e Prishtinës. Sidoqoftë, konsideroj që Kryetari dhe kryesuesi duhet ta procedojnë këtë çështje, ose ta diskutojmë sot në mbledhje, ose do ta diskutojmë në mbledhjen e ardhshme, e cila vetëm formalisht është ndarë në dy pjesë.

Sami Hamiti theksoi se në Komitetin për Politikë dhe Financa kërkuam një interpretim rreth emërimit të drejtorive të reja, sepse ne po procedojmë me një buxhet për vitin e ardhshëm, ku janë drejtoritë e reja, të shkruara para një viti, dhe kurrë nuk është bërë një vendim dhe nuk janë funksionalizuar ato drejtori.

Kreshnik Ahmeti shprehu rezervë për pikën e trembëdhjetë (13) të rendit të ditës, andaj propozoi që të hiqet nga rendi i ditës.

Dardan Sejdiu, nënkryetar, tha se në mbledhjen e KPF-së e kam sqaruar se drejtoritë e reja kërkojnë një vendim dhe ai vendim kërkon një dokument, i cili ka të bëjë me sistematizimin e vendeve të punës, i cili është në përfundim e sipër. Për këtë arsye edhe Kryetari i Komunës së Prishtinës, z. Shpend Ahmeti, ka vendosur që sot të sjellë te ju propozime të cilat janë në frymë të këtij diskutimi.

Qëndron Kastrati tha se mos miratimi i këtyre planeve rregulluese, brenda një periudhe gjashtë mujore, ka bllokuar këtë qytet në zhvillimin e planifikimit, urbanizmit dhe ndërtimit, dhe kërkesa e vetme e tyre politike ka qenë se nuk e votojnë një vendim i cili vjen nga drejtori Liburn Aliu.

Muhamet Selmani pyeti se cila është arsyeja e mungesës së Kryetarit në mbledhjet e Kuvendit.

Pas diskutimeve që kishin të bënin me rendin e ditës, kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës.

Kryesuesi konstatoi se me njëzet e një (21) vota për dhe me njëzet e katër (24) vota kundër (Halim Halimi, Hazir Borovci, Sami Hamiti, Agim Gashi, Shefki Gashi, Shaip Hajrizi, Abit Kastrati, Sokol Krasniqi, Bekim Gashi, Naime Osmani, Vjollca Dibra- Ibrahim, Ajnishahe Azemi, Hasime Krasniqi, Merita Surkishi, Flamur Shala, Shiqeri Spahiu, Besa Rafuna, Lirak Çelaj, Muhamet Selmani, Lirie Avdiu, Blerand Stavileci Laura Zherka, Lirijeta Rexhepi dhe Shemsi Veseli), (sipas rendit të ditës të propozuar nga Kryetari dhe kryesuesi), nuk u miratua rendi i ditës.

Dardan Sejdiu, nënkryetar, tha se është e qartë dhe evidente që nuk ekziston vullneti që të trajtohen pikat e rendit të ditës që vijnë nga kabineti i Kryetarit të Komunës, dhe që ky vullnet përveçse është tashmë i qartë në aspektin të themi bllokues, është edhe skajshmërisht jo i sinqertë. Pra, ekzekutivi ka sjell vendime nga Kryetari i Komunës dhe grupi i asamblastëve të PDK-së, LDK-së, përkundër diskutimit gjashtëmujor, kanë

vendosur sot që të votojnë kundër, andaj lus ekzekutivin e Komunës së Prishtinës që ta lëshojë sallën.

Qëndron Kastrati tha se edhe ne si GP konsiderojmë se qëllimi është vetëm bllokimi, nuk është arsyeja në të cilën janë thirrur më herët, që sot është evituar.

Edhe ne si këshilltarë të Kuvendit të Komunës që i takojmë subjektit politik LVV, nuk do të marrim pjesë në këtë mbledhje, dhe i ftojme të gjithë këshilltarët e tjerë, të cilët konsiderojnë që kërkesa prej GP të LDK-së dhe PDK-së është e padrejtë, ta lëshojnë mbledhjen.

Pas debatit rreth rendit të ditës, GP i LVV-së, GP i AAK-së, përfaqësuesi i subjektit politik KDTP dhe përfaqësuesi i subjektit politik GIS, e lëshuan mbledhjen.

Kryesuesi tha se të pranishëm në sallë janë tridhjetë e katër (34) anëtarë të Kuvendit dhe konstatoj se ekziston kuorumi për vazhdimin e mbledhjes. Propozimi ishte që pikat: *Propozimvendimi për miratimin – lënie në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues të lagjes “Kalabria”;* *Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të lagjes “Mati 1” dhe Propozimvendimi për dhënien e pëlqimit për ndryshime në infrastrukturë në një pjesë të Planit rregullues të lagjes “Lakërishta” në Prishtinë, të hiqen nga rendi i ditës.*

Me propozimet e dhëna, Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës.

Kryesuesi konstatoi se me tridhjetë e dy (32) vota për dhe dy (2) vota kundër, (Feti Mehdiu dhe Visar Arifaj), u miratua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së gjashtë dhe mbledhjes urgjente;
2. Propozimbuxheti për vitin 2016 dhe shqyrtimi i Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2016-2018;
3. Propozimrregullorja për tatim në pronën e paluajtshme;
4. Proozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër;
5. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë;
6. Propozimrregullorja për rrugët lokale;
7. Caktimi i komisionit për përzgjedhjen e kryetarëve të Bashkësive lokale;
8. Plotësimvendimi për anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
9. Caktimi i anëtarëve të grupit punues për plotësimin dhe hartimin e Rregullores për Bashkësi lokale;
10. Shqyrtimi i peticionit të banorëve të lagjes “Prishtina e Re” lidhur me Planin urbanistik;

11. Propozimvendimi i Komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në komunën e Prishtinës;
12. Pyetje dhe përgjigje;
13. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së gjashtë dhe mbledhjes urgjente.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratuan ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjes së gjashtë dhe mbledhjes urgjente të Kuvendit.

Pika e dytë

Propozimbuxheti për vitin 2016 dhe shqyrtimi i Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2016-2018.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kryesuesi hapi diskutimin.

Për Propozimbuxhetin të vitit 2016 dhe Kornizën afatmesme buxhetore për periudhën kohore 2016- 2018, diskutuan: Sami Hamiti, shef i GP të LDK-së, Muhamet Selmani, në emër të GP të PDK-së, Remzi Pacolli, në emër të GP të AKR-së, Abetare Fazliu, në emër të GP të LB-së, Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik të PF-së, Agim Gashi, Mirlinda Sopi, Shemsi Veseli, Sofije Bunjaku, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

GP i LDK-së propozoi që në buxhetin e vitit 2016 të planifikohen këto projekte: kanalizimi nga Pallati i Drejtësisë në drejtim të Çagllavicës; kanalizimi nga Fusha e Pajtimit - Llukar - Grashticë; rrjeti i ujësjellësit për fshatrat Grashticë dhe Mramor; Barilevë, rruga e Kurtollëve; staza e biçiklistëve Gërmi - Parku i Arinjve - 5 km dhe rritja e subvencioneve në bujqësi nga 500.000 në 700.000 €.

GP i AKR-së propozoi që të planifikohen në buxhetin e vitit 2016 këto projekte: Nuk e pajtohem me zvogëlimin e buxhetit për infrastrukturën rrugore për zona rurale, rruga mbi lumin Mati është intervenim i domosdoshëm; kolektori i ujërave të zeza në Hajvali; rruga Vidime - xhamia e Marecit; rruga Busi - Vidime, që lidhë Mramorin me Marecin; varrezat dhe pagesat për shpenzimet e varrimit të qytetarëve të komunës së Prishtinës; rruga nga Veterniku në drejtim të Pallatit të Drejtësisë.

GP i PDK-së propozoi që të planifikohen në buxhetin e vitit 2016 këto projekte: ndërtimi i rrugëve në pjesët urbane me infrastrukturë përcjellëse; ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukturë përcjellëse; ndërtimi i nënkalimit që lidh lagjen "Lakërishta" me lagjen "Dardania"; ndërtimin e rrugës në lagjen "Spahiaj" në fshatin Mramor, rruga "Evlija Qelebiu" në Prishtinë; ndërtimi i dy urave të fshatit Barilevë; trotuari dhe ndriçimi i rrugës kryesore në fshatin Drenovc; rruga nga fshatin Barilevë në lagjen "Kurtolli", kanalizimi dhe ujësjellësi; lagja "Llumnica", riparimi i rrugës

kryesore, si dhe ndërtimi i aneksit nga lagjja që e lidhë me fshatin Barilevë; lagjja "Verbovci", vazhdimi i rrugës deri te varrezat e lagjes; lagjja "Xhafolli" fshati Drenovc, rruga kryesore e lagjes; rruga "1 Tetori" Prishtinë, nga shkolla fillore "Gjergj Fishta" deri te Parku i Qytetit; rruga "Malush Kosova", Mat 1, Prishtinë (asfaltimi i rrugës); rruga "Vlora", në lagjen "Kodra e Trimave", Prishtinë (asfaltimi i rrugës); rruga Ballaban - Nishevc (asfaltimi i rrugës); rruga Ballaban - Kushevicë, (asfaltimi i rrugës); rruga "Antigona Fazliu", Prishtinë, (afër shkollës "Pjeter Bogdani") dhe ndriçimi i rrugës kryesore në fshatin Tenezhdoll.

Për shpenzimet e varrimit të ndahet një buxhet i veçantë.

Gjithashtu u kërkua që në kodet buxhetore: Pika 1.4.3.1, pika 1.4.3.2, pika 1.4.3.6, pika 1.4.3.7, pika 1.4.3.16 dhe pika 1.4.3.8, të planit buxhetor të Komunës për vitin 2016, të parashihen mjete shtesë për realizimin e projekteve.

Me propozimet e dhëna, që ato të inkorporohen në tekstin final, kryesuesi konstatoi se me njëzet e nëntë (29) vota për, një (1) votë kundër (Mirlinda Sopi) dhe dy (2) abstenime (Visar Arifaj dhe Feti Mehdiu), u miratua Propozimbuxheti për vitin 2016 dhe shqyrtimi i Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2016-2018.

Pika e tretë

Propozimrregullorja për tatim në pronën e paluajtshme.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, diskutuan Visar Arifaj, Lirak Çelaj, Islam Pacolli dhe Naime Osmani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi konstatoi se me njëzet e gjashtë (26) vota për, një (1) votë kundër (Visar Arifaj) dhe dy abstenime (Naime Osmani dhe Feti Mehdiu) u miratua Rregullorja për tatim në pronën e paluajtshme.

Pika e katërt

Propozimvendimi për dhënien e pronës së pa luajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër.

Sami Hamiti në emër të GP të LDK-ës, propozoi që neni 4 i vendimit, i cili parasheh afatin kohor prej 15 vjetëve, të jetë afatgjatë, në periudhën prej 20 vjetëve.

Për këtë temë diskutuan edhe Lirak Çelaj, Islam Pacolli, Visar Arifaj GP i PF-së dhe Muhamet Selmani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Me propozimin e dhënë nga GP i LDK-së, që të inkorporohet në tekstin final, Kryesuesi konstatoi se me njëzet e nëntë (29) vota për, një (1) votë kundër (Visar Arifaj) dhe një (1)

abstenim (Feti Mehdiu), u miratua Vendimi për dhënien e pronës së pa luajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër.

Pika e pestë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë.

Kryesuesi konstatoi se me njëzet e shtatë (27) vota për, një (1) votë kundër (Visar Arifaj) dhe një (1) abstenim (Feti Mehdiu), u miratua Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë.

Pika e gjashtë

Propozimrregullorja për rrugët lokale.

Lidhur me këtë pikë, **Shemsi Veseli** bëri vërejtje në nenin 10 dhe në nenin 24, i cili propozoi që këto nene të korrigjohen dhe të riformulohen më mirë.

Për këtë pikë diskutuan edhe Agim Gashi, Lirak Çelaj dhe Sami Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Me vërejtjet e dhëna që të inkorporohen në tekstin final, kryesuesi konstatoi se me njëzet e nëntë (29) vota për dhe dy (2) abstenime (Feti Mehdiu dhe Kimet Zeqa), u miratua Rrregullorja për rrugët lokale.

Pika e shtatë

Kryesuesi tha se në mungesë të ekzekutivit dhe me kërkesën e anëtarëve të Kuvendit, caktimi i Komisionit për përzgjedhjen e kryetarëve të Bashkësive lokale, shtyhet për diskutim për mbledhjen e radhës së Kuvendit.

Pika e tetë

Plotësimvendimi për anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Kryesuesi konstatoi se me njëzet e nëntë (29) vota për dhe dy (2) abstenime (Feti Mehdiu dhe Kimet Zeqa), u miratua Vendimi për anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Pika e nëntë

Caktimi i anëtarëve të grupit punues për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për bashkësi lokale.

Kryesuesi konstatoi se me njëzet e nëntë (29) vota për dhe dy (2) abstënime (Feti Mehdiu dhe Kimet Zeqa), kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për diskutim për mbledhjen e radhës së Kuvendit.

Pika e dhjetë

Shqyrtimi i peticionit të banorëve të lagjes “Prishtina e Re” lidhur me Planin urbanistik

Kryesuesi i njoftoi të pranishmit lidhur me shqyrtimin e peticionit, duke cekur se ne nuk mund të marrim asnjë vendim, ngase është Drejtorja e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e cila është e obliguar që të merret me këtë çështje.

Për këtë pikë diskutuan Sami Hamiti, Lirak Çelaj, Mirlinda Sopi, Shefki Gashi, Abetare Fazliu dhe Shemsi Veseli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi konstatoi se me njëzet e nëntë (29) vota për, një (1) votë kundër (Halim Halimi, kryesues) dhe një abstënime (Feti Mehdiu), u miratua peticioni i banorëve të lagjes “Prishtina e Re”.

Pika e njëmbëdhjetë

Propozimvendimi i Komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në komunën e Prishtinës.

Bekim Gashi, propozoi që rruga me nr. 19-12483 në fshatin Hajvali, të emërtohet me emrin Ruhan Pacolli.

Lirak Çelaj tha se në këtë Kuvend është marrë një vendim paraprak për emërtimin e shesheve “Adem Demaçi” dhe “Ukshin Hoti”, andaj kërkoj që ky vendim të realizohet.

Për këtë temë diskutuan Shefki Gashi, Remzi Pacolli, Visar Arifaj, Muhamet Selmani, Mirlinda Sopi, Abetare Fazliu, Remzi Pacolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Visar Arifaj, propozoi që një rrugë të emërohet me emrin e tij.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna, sqarime të nevojshme dha Florina Rrahmani, anëtare e Komisionit për emërtimin e rrugëve.

Kryesuesi konstatoi se me propozimin e z. Bekim Gashi dhe z. Lirak Çelaj, që propozimet e tyre të inkorporohen në listën e rrugëve, me njëzet e tetë (28) vota për, një (1) votë kundër, (Visar Arifaj) dhe një abstënime (Kimet Zeqa), u miratua Vendimi i Komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në komunën e Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se propozimi i z. Visar Arifaj për emërtimin e një rruge me emrin e tij, nuk u miratua nga të pranishmit.

Pika e dymbëdhjetë

Të ndryshme

Visar Arifaj kërkoi që materialet e mbledhjeve të jenë në formë digjitale e jo të skanuara.

Abetare Fazliu ngriti një shqetësim rreth parkingut të automjeteve në lagjen “Kodra e Diellit”, duke thënë se për banorët e kësaj lagjeje është një shqetësim i madh, pasi që për veturat e parkuara para banesave ju shqiptohen dënimi me gjobë prej 25 €. Kjo është e paarsyeshme, sepse banoret nuk kanë vend ku t’i parkojnë veturat.

Feti Mehdiu ngriti shqetësimin e banorëve të lagjes “Matiçan”, ku kompania “Pastrimi” ka emërtuar një rrugë me emrin “Arif Rama 1”, e që sipas qytetarëve të asaj lagjeje, nuk ekziston kjo rrugë. Kjo është jo serioze, andaj Komuna duhet marrë masa për këtë çështje.

Njëherësh ai tha se Partia e Drejtësisë distancohet nga të gjitha inatet që reflektojnë në Kuvendin e Komunës së Prishtinës, por edhe nga shakatë e tepruara.

Shemsi Veseli bëri të ditur se në mbledhjen e kaluar kishte kërkuar që për këtë mbledhje të debatohet Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Prishtinës, për të cilën nuk është kthyer asnjë përgjigje. Njëherësh kërkoi që për mbledhjen e radhës, në rend dite të jetë edhe raporti financiar i tremujorit të dytë.

Lirie Avdiu paraqiti kërkesën në emër të Shoqatës së Grave të Verbra të Komunës së Prishtinës, e cila ka kërkuar që Komuna e Prishtinës të përkujdeset për zbatimin e Ligjit për të verbër, i cili parasheh që anëtarët e shoqatës të lëvizin pa pagesë në linjat e ndërmarrjes “Trafiku Urban”.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Halim Halimi, jur. i dipl.